- Permiresimet ne Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar (botuar ne maj 2008). Ne vitin 2007, BSNK vendosi te filloje nje projekt permiresimi si nje metode per bere ndryshime te nevojshme, por jo urgjente, ne SNRF. Ndryshimet konsistojne ne ndryshime thelbesore, sqarime si dhe ndryshime ne terminologjine e perdorur ne standarde te ndryshme. Ndryshimet thelbesore te cilat gjejne zbatim per Shoqerine kane te bejne me fushat e meposhtme: njohja e shitjes se aktiveve sipas IAS 16 te cilat jane mbajtur me pare per qiradhenie dhe klasifikimi i flukseve monetare te lidhura me to sipas IAS 7 si flukse monetare nga aktivitetet operative ; permiresimi i shenimeve shpjeguese te cilat kerkohen nga IAS 36; sqarime mbi njohjen e shpenzimeve te reklamimit sipas IAS 38; dhe ndryshimi i perkufizimit te vleres se drejte nepermjet fitimeve ose humbjeve per te qene ne perputhje me njohjen e instrumentave mbrojtjes (hedging) sipas IAS 39. Ndryshime te tjera te IAS 8,10,18,20,29,34,40,41 dhe te IFRS 7 perbejne ndryshime ne terminologji ose editoriale, per te cilat BSNK beson se nuk kane efekt ose kane efekt minimal ne kontabilitet. Shoqeria nuk pret qe ndryshimet e mesiperme te kene ndikim material ne pasqyrat e saj financiare.
- Ndryshimet ne SNK 32 “Instrumentat financiare – Paraqitja” dhe SNK 1 “Paraqitja e pasqyrave financiare” – Instrumentat financiare (Puttable) dhe obligacionet te cilat lindin gjate likuidimit (efektive per periudha te cilat fillojne me ose pas 1 janarit 2009). Shoqeria

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

nuk pret qe ndryshimet e mesiperme te kene ndikim material ne pasqyrat e saj financiare.

- SNK 23 (i ndryshuar) “Kostot e Huamarrjes” (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2009). SNK 23 (i ndryshuar) kerkon qe shoqerite te kapitalizojne kostot e huamarrjes te cilat lidhen dretperdrejt me blerjen, ndertimin ose prodhimin e nje aktivi i cili kualifikohet (nje aktiv i cili kerkon nje periudhe te caktuar kohore per t'u sjelle ne gjendje per shitje apo perdorim) si pjese e vleres se atij aktivi. Opsioni i njohjes menjehere ne shpenzime te ketyre kostove nuk ekziston me. Politikatkontabel e ndjekur nga Shoqeria eshte ajo e kapitalizimit te kostove te huamarrjes te cilat lidhen me aktive qe kualifikohen. Ky ndryshim nuk ka asnje efekt mbi rezultatin e raportuar.
- Ndryshimet ne SNRF 2 “Pagesat nepermjet aksioneve” – Kushtet e transferimit dhe anulimit (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2009). Ndryshimet ne SNRF 2 nuk jane te aplikueshme per aktivitetin e Shoqerise.
- Ndryshimet ne KISNRF 9 “Rivleresimi i Derivativeve te Perfshire” dhe SNK 39 “Instrumentat financiare: Njohja dhe matja” – Derivatet e Perfshire (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 30 qershorit 2009). Shoqeria nuk pret qe keto ndryshime te kene ndikim material ne pasqyrat e saj financiare.
- KISNRF 13 “Programet per Besnikerine e Konsumatorit” (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 korrikut 2008). Shoqeria nuk pret qe keto ndryshime te kene ndikim material ne pasqyrat e saj financiare.
- KISNRF 15 “Marreveshjet per Ndertimin e Pasurive te Patundshme” (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2009). Shoqeria vendosi qe keto ndryshime nuk kane ndikim material ne pasqyrat e saj financiare.
- KISNRF 16 “Mbrotja e nje Investimi Neto ne Aktivitete te Huaja” (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 tetorit 2008). Shoqeria vendosi qe keto ndryshime nuk kane ndikim material ne pasqyrat e saj financiare.

Standarde dhe interpretime te cilat priten te hyjne ne fuqi

Ne daten e miratimit te ketyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e meposhtme jane miraturar por nuk kane hyre ende ne fuqi:

- SNRF 1, Adoptimi per here te pare i SNRF (ne vijim te nje ndryshimi ne dhjetor 2008, ne fuqi per pasqyrat e para financiare sipas SNRF per periudha qe fillojne me ose pas 1 korrikut 2009). SNRF i rishikuar ruan permbajtjen e versionit te tij te meparshem por, me ndryshime ne strukture per ta bere me te kuptueshem per lexuesin dhe per te bere me te lehte pershtatjen e ndryshimeve te ardhshme. Shoqeria arriti ne perfundimin se standartet e rishikuara nuk kane ndonje efekt ne pasqyrat financiare.
- Permiresimi i Shenimeve Shpjeguese per Instrumentat Financiare – Ndryshim i SNRF 7, Instrumentat financiare: Shenimet shpjeguese (botuar ne mars 2009; ne fuqi per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2009). Ndryshimi kerkon permiresim te shenimeve shpjeguese ne lidhje me matjen e vleres se drejte dhe riskut te likuiditetit. Njesise do t'i kerkohet te paraqese nje analize te instrumentave financiare duke perdorur nje hierarki matese te vleres se drejte me tre nivele. Ndryshimi (a) sqaron se analiza e maturimit te detyrimeve duhet te perfshije kontrata te garancise financiare te leshuara ne masen

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009**

maksimale te garancise ne periudhen me te hershme ne te cilen kjo garanci mund te kerkohet; dhe (b) kerkon shpjegime ne lidhje me maturimet kontraktuale te derivativeve fiananciare nese maturimet kontraktuale jane esenciale per te kuptuar frekuencen kohore te flukseve monetare. Nje njesie do t'i duhet te paraqese nje analize te maturimit te aktiveve financiare qe ajo mban per menaxhimin e rrezikut te likuiditetit, ne qofte se informacioni eshte i nevojshem per t'u mundesuar perdoruesve te pasqyrave financiare te vleresojne natyren dhe shkallen e riskut te likuiditetit. Aktualisht, Shoqeria eshte duke vleresuar impaktin e ndryshimeve te informacioneve shpjeguese ne pasqyrate e saj financiare.

- SNRF per Ndermarrjet e Vogla dhe te Mesme (NVM) (botuar ne korrik 2009) eshte nje standard me vehte , i pershtatur per nevojat dhe kapacitetet e bizneseve te vogla. Shume nga parimet e SNRF-ve te plota per njohjen dhe matjen e aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpezimeve jane thjeshtezuar dhe numri i dhenies se informacioneve shpjeguese eshte thjeshtezuar dhe reduktuar ne menyre te ndjeshme. SNRF-ja per NVM-te mund te zbatohet per njesite qe publikojne pasqyrat financiare per qellime te pergjithshme per perdoruesit e jashtem dhe qe nuk kane pergjegjesi publike. Shoqeria nuk do te aplikojte SNFR-ne per NVM-te.
- Perjashtime Shtese per Adoptimin per Here te Pare – Ndryshime te SNRF 1, Adoptimi i IFRS per Here te Pare (ne fuqi per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2010). Ndryshimet perjashtojne njesite qe perdorin metoden e koston se plote nga zbatimi retrospektiv i SNRF-ve per pasurite e naftes dhe gazit dhe perjashton gjithashtu njesite me kontrata ekzistuese qiraje financiare nga rishqyrtimi i klasifikimit te atyre kontratave sipas IFRIC 4 'Percaktimi Nese nje Marreveshje Permban nje Qira' kur aplikimi i kerkesave te standardeve kombetare te kontabilitetit prodhon te njejtin rezultat. Ndryshimet nuk do te kene ndonje impakt ne pasqyrat financiare te Shoqerise.
- SNK 24, Shenimet shpjeguese mbi palet te lidhura (ndryshuar ne nentor 2009, ne fuqi per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2011). SNK 24 u rishikua ne 2009 duke: (a) thjeshtezuar perkufizimin e paleve te lidhura, duke qartesuar kuptimin e tij dhe duke eliminuar mosperputhjet me perkufizimin dhe (b) duke siguruar nje perjashtim te pjesshem nga kerkesat per shenime shpjeguese per njesite e lidhura shtetore. Kompania eshte aktualisht duke vleresuar impaktin e ndryshimeve ne kerkesat per shenimet shpjeguese ne pasqyrat e saj financiare
- IFRIC 17, Shperndarja e Aktiveve Jo-monetare tek Pronaret (ne fuqi per periudha qe fillojne me ose pas 1 korrikut 2009). Ndryshimi sqaron kur dhe si duhet te njihet shperndarja e asetave jo-monetare si dividend. Nje njesi duhet te vleresojte detyrimin per shperndarjen e asetave jo-monetare si dividende duke perdorur vleren e drejte te asetave per t'u shperndare. Nje fitim ose humbje nga shitja e asetave jo-monetare te shperndara do te njihet si fitim ose humbje kur subjekti te percaktojte dividendin e pagueshem. IFRIC 17, nuk eshte relevant me aktivitetin e Shoqerise duke qene se ajo nuk u shperndan asete jo-monetare pronareve.
- KISNRF 18, Transferimi i aktiveve nga klientet (hyn ne fuqi per transferimet e aktiveve nga klientet te marra me ose pas 1 korrikut 2009 dhe lejohet dhe aplikim me i hershem). Interpretimi sqaron trajtimin kontabel te transferimeve te aktiveve nga klientet, perkatesisht kushtet te cilat duhet te permbushen per kualifikimin si nje aktiv, njohjen e nje aktivi, identifikimin e sherbimeve te identifikueshme vecmas (nje ose me shume sherbime ne kembim te aktiveve te tranferuara); njohjen e te ardhurave, dhe trajtimin kontabel te transferimit te mjeteve monetare nga klientet. KISNRF 18 nuk pritet te kete ndonje impakt ne

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

pasqyrat financiare te Shoqerise.

- SNRF 9, Instrumentat Financiare (botuar ne nentor 2009, ne fuqi per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2013 por lejohet zbatimi edhe para kesaj date). SNRF 9 zevendeson ato pjese te SNK 39 ne lidhje me klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Karakteristikat thelbeshore jane si me poshte:
 - Aktivet financiare kerkohet te klasifikohen ne dy kategori matese: ato qe maten ne vazhdim me vlere te drejte, dhe ato qe qe maten ne vazhdim me vlere te amortizuar. Vendimi duhet marre ne momentin e njohjes fillestare. Klasifikimi varet nga modeli i vete shoqerise per menaxhimin e instrumentave financiare si dhe nga karakteristikat kontraktuale te flukseve monetare ne lidhje me instrumentin.
 - Nje instrument matet ne menyre te vazhdueshme me vlere te amortizuar vetem nese eshte instrument borxhi dhe (i) synimi i modelit te biznesit te njesise eshte te mbaje aktivin per te fituar mjete monetare qe rrjedhin nga kontrata, dhe (ii) mjetet monetare qe rrjedhin nga kontrata perfaqesojne vetem pagesa te principalit dhe interesit (pra, instrumenti ka "karakteristikat baze te nje huaje"). Te gjitha instrumentat e tjere te borxhit duhet te maten me vleren e drejte nepermjet fitimeve apo humbjeve.
 - Te gjitha instrumentat e kapitalit duhet te maten ne vazhdim me vlere te drejte. Instrumentat e kapitalit qe mbahen per t'u tregtuar do te maten me vlere te drejte nepermjet fitimit apo humbjes. Per te gjitha investimet e tjera te kapitalit mund te behet nje zgjedhje e pakthyeshme ne momentin e njohjes fillestare per te njohur fitimet dhe humbjet e realizuara dhe te parealizuara nga kembimi nepermjet te ardhurave dhe shpenzimeve gjithepershires ne vend te fitimeve dhe humbjeve. Nuk mund te kryhet riciklimi i te ardhurave ose humbjeve qe rezultojne nga matja me vlere te drejte ne fitime ose humbje. Kjo zgjedhje mund te behet vecmas per cdo instrument. Dividendet do te paraqiten ne fitime ose humbje per sa kohe qe ata perfaqesojne fitime nga investimi.
- Ndryshimet ne SNRF 2 "Pagesat Nepermjet Aksioneve" – Transaksionet e pagesave ne para ne baze grupi nepermjet aksioneve (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2010). Ndryshimet ne SNRF 2 nuk priten te kene ndonje efekt mbi pasqyrat financiare te Shoqerise.
- Ndryshimet ne SNK 27 "Pasqyrat Financiare te Konsoliduara dhe Individuale" (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 korrikut 2009). Ndryshimet ne SNK 27 nuk priten te kene efekt mbi pasqyrat financiare te Shoqerise.
- Ndryshimet ne SNK 32 "Instrumentat Financiare: Paraqitja" – Trajtimi kontabel i emetimit te te drejtave (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 shkurtit 2010). Ndryshimet ne SNK 32 nuk priten te kene efekt mbi pasqyrat financiare te Shoqerise.
- KISNRF 19 "Shlyerja e Detyrimeve Financiare me Instrumentat e Kapitalit (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 korrikut 2010). KISNRF sqaron trajtimin kontabel kur nje njesi rinegocion kushtet e borxhit dhe rezulton qe detyrimi shlyhet nepermjet emetimit te instrumentave te kapitalit nga debitori per kreditorin. Nje fitim ose humbje njihet ne pasqyren e fitimeve dhe humbjeve mbi bazen e vleres se drejte te instrumentave kapitale krahasuar me vleren kontabel neto te borxhit. Shoqeria eshte aktualisht duke vleresuar impaktin e interpretimit te ketij standardi ne pasqyrat e saj financiare.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

- Parapagimet per Kerkesat e Financimeve Minimale - Ndryshim i KISNRF 14 (efektive per periudha qe fillojne me ose pas 1 janarit 2011). Ky ndryshim do te kete nje impakt te kufizuar meqenese zbatohet vetem nga shoqerite qe kerkohen te kryejne kontribute financiare minimale ne nje plan pensioni te percaktuar. Ndryshimi heq nje pasoje te padeshiruar te KISNRF 14 ne lidhje me parapagesat e pensioneve vullnetare kur kerkohet nje minimum financimi. Aktualisht Shoqeria eshte duke vleresuar impaktin e interpretimeve te ndryshuara ne pasqyrat e saj financiare.

Shoqeria ka vendosur te mos adoptoje keto standarde, rishikime dhe interpretime perpara datave te hyrjes se tyre ne fuqi. Sic sqarohet dhe me siper, Shoqeria parashikon se adoptimi i ketyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do kete ndikim material ne pasqyrat e saj financiare ne periudhen e aplikimit te tyre per here te pare.

2.2 Monedha Raportuese

(a) Monedha funksionale dhe raportuese:

Shumat e përfshira në pasqyrat financiare të Kompanisë janë vlerësuar bazuar mbi mjedisin primar ekonomik në të cilin vepron njësia - LEK ("monedha funksionale"). Pasqyrat financiare të konsoliduara janë paraqitur në LEK, që përfaqëson monedhën e prezantimit të kompanisë.

(b) Transaksionet dhe tepricat e llogarive ne monedhe te huaj:

Transaksionet ne monedhe te huaj jane perkthyer ne monedhen funksionale duke perdorur kursin e kembimit te dates perkatese te transaksionit. Aktivet dhe detyrimet ne monedhe te huaj ne daten e ndertimit te Bilancit Kontabel jane perkthyer ne Lek duke perdorur kursin e kembimit te asaj date. Fitimet dhe humbjet e rezultuara nga perkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare dhe nga transaksionet e kembimit jane njohur dhe jane perfshire ne paqyren e te ardhurave.

(c) Kurset e kembimit me monedhat e huaja:

Më 31 dhjetor 2008 aktivet monetare, detyrimet monetare janë konvertuar dhe paraqitur me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë; EURO/LEK 137.96 (31 dhjetor 2008: 123.80) dhe kursi mesatar i perdorur per te konvertuar zerat e te ardhurave dhe shpenzimeve: EURO/LEK 132.66 (2008: 122.80).

2.3 Aktivet Afatgjata Materiale:

Aktivitet Afatgjata Materiale si ; Pronat, tokat dhe paisjet jane paraqitur ne Bilancin Kontabel me koston historike neto me zhvleresimin e akumuluar. Kosto historike perfshin te gjitha shpenzimet qe i atribuohen ne menyre te drejperdrejte marrjes se aktivitet.

Kostot shtese te aktiveve perfshihen ne vleren e mbartur te aktiveve ose njlhen si nje aktiv me vete vetem ne rast se eshte e mundur qe ne te ardhmen perfitime te lidhura me aktivin do te hyjne ne kompani dhe ne qofte se kostoja(vlera) e aktivitet mund te matet ne menyre te besueshme. Vlera e mbartur e pjeseve te aktivitet te zevendesuara c`regjistrohet nga kontabiliteti. Te gjitha shpenzimet e tjera te riparimit dhe mirembajtjes perfshihen ne pasqyren e te ardhurave te periudhes kur ato kryhen.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009**

Toka nuk zhvleresohet. Zhvleresimi i aktiveve te tjera eshte llogaritur duke perdorur metoden e vleres se mbetur per te shperndare koston e aktivitet gjate gjithe jetes se tij te dobishme. Zhvleresimi llogaritet per secilin aktiv deri deri sa kostoja e tij te zhvleresohet plotesisht ose deri ne vleren e tij te mbetur nese ajo eshte materiale

Perqindjet e zhvleresimit vjetor bazuar ne jeten e dobishme te aktiveve jane si vijon:

Pershkrimi: Jetegjatesia ne vite:

Mjete Motorrike	4
Paisje zyre	4
Mobilje	5
Kompjuter	4

Vlera dhe jeta e mbetur e aktiveve rishikohen ne cdo date ndertimi te Bilancit Kontabel pasqyrohet nese ndryshimi eshte material. Vlera e mbetur e aktivitet zvogelohet deri ne vleren e tij te realizueshme ne rast se vlera mbetur tejkalon vleren e realizueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja percaktohen nga krahasimi i vleres se realizuar dhe koston historike dhe perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

2.4 Aktivet Afatgjata Jomateriale:

Aktivitet afatgjata jomateriale perfshijne licensat e software-ve. Licensat e software-ve kompjuterike jane kapitalizuar ne baze te kostove dhe shpenzimeve te ndodhura te nevojshme per marrjen dhe venien ne perdorim te software-it perkates specifik. Kostoja e tyre amortizohet pergjate jetes se tyre te dobishme te llogaritur (pese vjet).

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

2.5 Zhvleresimi i aktiveve jo financiare:

Aktivet te cilat jane subjekt i zhvleresimit dhe amortizimit rishikohen ne lidhje me renien e vleres sa here qe ngjarje dhe ndryshime te rrethanave tregojne qe vlera e mbartur mund te mos rikuperohet. Nje humbje nga renia ne vlere njihet per shumen qe vlera e mbartur tejkalon vleren e rikuperueshme., Vlera e rikuperueshme eshte vlera me e larte ndermjet vleres se drejte te aktivitet pakesuar me kostot e shitjes dhe vleres ne perdorimi te aktivitet. Per vleresimin e zhvleresimit, aktivet grupohen ne njesi gjenerike me te vogla , flukset monetare te te cilave jane lehtesisht te identifikueshme .Aktivet jo financiare te cilat kane pesuar nje renie ne vlere rishikohen ne cdo date raportimi per ndonje rritje te mundshme te vleres.

2.6 Huate dhe Llogarite e arketueshmet

Huate dhe te arketueshmet jane aktive financiare joderivative me pagesa fikse ose te percaktuara dhe nuk jane te listuara (kuotuar) ne nje treg aktiv. Ato jane perfshire ne aktivet rrjedhese (afat-shkurtra) pervec huave dhe te arketueshmeve me afat maturimi me te madh se 12 muaj nga data e bilancit, te cilat jane klasifikuar si aktive jo- rrjedhese(afat-gjata).

Kompania vlereson ne cdo date bilanci nese ekziston nje evidence objektive qe nje, ose nje grup aktivesh financiare ka pesuar renie ne vlere.

2.7 Qeraja Financiare

Kur kompania eshte Qeradhenesi

Nje qera perkufizohet si nje mareveshje midis qeradhenesit dhe qeramarresit, ku qeradhenesi jep me qera nje aktiv dhe te drejten e perdorimit te tij per nje peridhje te percaktuar kohe, ne kembim te nje pagese ose te nje serie pagesash nga ana e qeramarresit. Nje qera mund te klasifikohet si qera operative(e shfrytezimit) ose si qera financiare.

Qerate financiare jane qera ku risqet dhe perfitimet qe lidhen me perdorimin dhe pronesine e aktivitet transferohen ne menyre thelbësore nga qeradhenesi tek qeramarresi. Titulli ligjor i pronesise mund te transferohet ose jo. Qerate operative jane te gjitha qerate e tjera pervec qerave financiare.

Ne rastin e qerases financiare kompania njeh ne bilancin e saj kontabel aktivin e dhene me qera financaire si nje te drejte te arketueshme te barabarte me vleren e investimit neto ne qera financiare. Vlera e investimit neto ne qera financiare eshte investimi bruto ne qera financiare i skontuar me normen e interesit te perfshire ne kontraten e qerases. Norma e interesit e perfshire ne kontraten e qerases (norma e nenkuptuar e qerases) eshte norma e skontimit e cila ne fillim te afatit te qerases barazon totalin e vleres aktuale te pagesave minimale te qerases dhe vleres se mbetur te pagarantuar me shumen e vleres se drejte dhe kostove qe lidhen ne menyre direkte me aktivin e dhene me qera nga qeradhenesi. Diferenca

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE**Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009**

ndermjet vleres bruto te te arketueshmeve dhe vleres se tyre aktuale perben te ardhuren financiare te pa perfituar. Te adhurat nga qeraja financiare njihen pergjate periudhes se qerese sipas nje baze sistematike duke perdorur metoden e investimit neto, e cila reflekton normen konstante periodike te kthimit ne investimin neto te qeradhenesit.

Kur Kompania eshte Qeramarresi

Kompania jep me qera aktive te trupezuara te caktuara. Qerate ne te cilat jepen me qera aktive fikse te trupezuara ku kompania mban te gjitha risqet dhe perfitimet thelbesore qe lidhen me pronesine e aktivitetit dhe ku kompania eshte ne pozicionin e qeramarresit, klasifikohen si qera financiare. Qerate ne te cilat nje sasi konsiderueshme e risqeve dhe perfitimeve qe lidhen me pronesine e aktivitetit te dhene me qera nuk mbahen nga qeradhenesi, klasifikohen si qera operative. Pagesat e bera ne qerate operative perfshihen ne pasqyren e te ardhurave ne baze lineare pergjate periudhes se qerese.

2.8 Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe te arketueshmeve nga qerate financiare:

Nje aktiv financiar konsiderohet qe eshte zhvleresuar nese evidenca objektive tregojne qe nje ose me shume ngjarje kane patur ndikim negativ ne fluset e ardhme te perlllogaritura te ketij aktiviteti.

Nje humbje nga zhvleresimi ne lidhje me nje aktiv financiar i cili matet me koston e amortizuar, matet si diferenca ndermjet vleres se tij te mbartur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te skontuara me normen origjinale efektive te interesit.

Aktivet financiare te vecanta testohen ne lidhje me renien ne vlere mbi baze individuale. Aktivitetet financiare qe mbeten vleresohen kolektivisht ne grupe qe kane karakteristika te perbashketa te riskut te kreditit. Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne fitimet dhe humbjet e periudhes kur ndodh zhvleresimi. Nje humbje nga zhvleresimi mund te rimerret nese percaktohet ne menyre objektive nje ngjarje e ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Rimarrja njihet ne fitimet dhe humbjet.

Nje provision per zhvleresimin e te arketueshmeve krijohet atehere kur ekziston nje evidence objektive qe kompania nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha shumatat e percaktuara ne mareveshjen origjinale. Veshtiresite financiare thelbesore te debitorit, probabiliteti qe debitori te falimentoje ose te filloje nje riorganizim financiar, mungesa e aftesise paguese (mbi 30 dite), konsiderohen si faktore te cilet tregojne zhvleresimin e te arketueshmeve. Shuma e provizionit eshte diferenca ndermjet vleres se mbartur te aktivitetit dhe vleres aktuale e flukseve te ardhshme te skontuara me normen efektive origjinale te interesit. Vlera e mbartur e aktivitetit zvogelohet nepermjet perdorimit te nje llogarie reserve dhe shuma e humbjes njihet ne pasqyren e te ardhurave. Kur e arketueshmja behet e pambledhshme, ajo c`regjistrohet nga llogaria e reserves se krijuar. Rimarrja e shumave te c`regjistruara paraprakisht behet duke kredituar pasqyren e te ardhurave.

Per qellim te nje vleresimi te perbashket te renies ne vlere, aktivet financiare grupohen ne baze te karakteristikave te ngjashme te riskut te kreditit (per shembull; ne baze te procesit te gradimit te kompanise i cili merr ne konsiderate llojin e aktiveve, industrine, vendndodhjen gjeografike, statusin e shkuar dhe te tjere faktore te rendesishem). Keto karakteristika jane te rendesishme per matjen e flukseve te ardhshme per keto grupe aktivesh duke qene tregues

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

te aftesise se debitorit per te paguar te gjitha shumat sipas termave te percaktuara ne kontraten e aktivitet qe po vleresohet.

Flukset e ardhshme te parase te nje grupi aktivesh financiare qe vleresohen bashkarisht ne lidhje me zhvleresimin maten ne baze te te flukseve te kontraktuara te aktiveve te kompanise dhe te eksperiences se shkuar ne humbjet qe vijne nga aktivet financiare me karakteristika te ngjashme te riskut te kredise me aktivet qe ka kompania. Eksperienca e kaluar e humbjeve rregullohet me te dhenat e vëzhgimeve aktuale per te reflektuar efektin e kushteve aktuale te cilat nuk kane patur ndikim ne periudhen ne te cilen bazohet eksperienca e humbjeve te kaluara si dhe per te eliminuar efektet e periudhave te kaluara te cilat nuk ekzistojne ne periudhen aktuale.

2.9 C'rrëgjistrimi

Nje aktiv financiar c'rrëgjistrohet kur kompania humbet kontrollin mbi te drejtat kontraktuale te cilat lidhen me ate aktiv. Kjo ndodh kur te drejtat realizohen, skadojne ose jane dorezuar. Nje detyrim financiar c'rrëgjistrohet kur ai detyrim nuk ekziston me.

2.10 Inventari

Inventaret paqyrohen me me te voglen midis kostos dhe vleres neto te realizueshme. Vlera neto e realizueshme eshte cmimi i shitjes i vleresuar ne rrjedhen normale te biznesit zvogeluar me shpenzimet variable te shitjes.

Ne 31 Dhjetor 2009 kompania nuk kishte ne pronesi asnje artikull inventari.

2.11 Mjete Monetare

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to perfshijne parate ne dore, depozitat rrjedhese ne banke dhe te tjera depozita afat-shkurtra me afat maturimi me pak ose deri ne 3 muaj. Levizjet e flukseve monetare dhe ekuivalenteve me to tregohen ne Pasyren e Fluksit te Mjeteve Monetare (Cash- Flow) duke perdorur metoden indirekte.

2.12 Huamarrjet

Huate njihen fillimisht me vleren e tyre te drejte neto duke perfshire kostot e ndodhura te transaksionit. Ato me pas pasqyrohen me koston e amorizuar; cdo diference ndermjet shumes(neto nga kostot e transaksionit) dhe vleres se shpengimit njihet ne pasqyren e te ardhurave pergjate periudhes se huase duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Huate klasifikohen si detyrime korente (afat-shkurtra) pervec rastit kur kompania ka nje te drejte te pakushtezuar per te shtyre marreveshjen e detyrimit per nje periudhe prej te pakten 12 muaj pas dates se bilancit kontabel.

2.13 Shpenzime per Interesa

Shpenzimet per interesa perfshijne interesin e huave te marra. Diferencat ndermjet vleres nominale dhe shumave neto nga kostot e transaksionit te marra njihet ne pasqyren e te ardhurave pergjate periudhes se huase duke perdorur metoden e interesit efektiv.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

2.14 Tatimi mbi te ardhurat

Kompania eshte subjekt I tatimit mbi fitimin duke ju referuar ligjeve dhe rregullave te Republikes se Shqiperise. Norma e parashikuar ne legjislacionin shqiptar ne vitin 2009 ishte 10% (2008: 10%)

Shpenzimet e taksave perfshijne taksat aktuale dhe te shtyra. Taksat aktuale perbejne tatimet e pritshme te pagueshme mbi te ardhurat vjetore te tatueshme duke perdorur normat ne fuqi ne daten e bilancit, dhe cdo rregullim I tatimit te pagueshem ne lidhje me vitet e kaluara.

Tatimi I shtyre mbi te ardhurat eshte perfshire plotesisht duke perdorur metoden e detyrimeve ne bilanc, mbi diferencat e perkoheshme ndermjet bazes se tatueshme te aktiveve dhe detyrimeve dhe shumave te tyre te mbartura ne pasqyrat financiare. Tatimi i shtyre mbi te ardhurat eshte perlogaritur duke perdorur normat e taksave (sipas ligjit) te cilat kane qene ne fuqi ne daten e ndertimit te bilancit kontabel dhe qe parashikohet te aplikohen kur aktivi I lidhur me tatimin e shtyre eshte realizuar ose kur detyrimi I lidhur me tatimin e shtyre ka lindur.

Te drejtat taimore te shtyra njihen deri ne ate mase qe eshte e mundur qe perfitime te ardhshme tatimore do jene te mundshme ndaj te cilave mund te te cilat mund te mbulojne diferencat e perkoheshme.

2.15 Perfitimet e punonjesve

Detyrimet e pensioneve dhe perfitimet pas shkeputjes nga puna:

Ne rrjedhen normale te biznesit nepermjet reduktimit te pages mujore, kompania ben derdhje ne fondet e detyrueshme te pensioneve ne emer te punonjesve te saj ne zbatim te kerkesave te legjislacionit ne fuqi. Te gjitha kontributet e bera ne fondet e detyrueshme te pensioneve parqyrohen se bashku me shpenzimet e pages bruto ne kohen kur ato ndodhin. Kompania ben pagesa ne fond ne emer te punonjesve te saj duke reduktuar nje pjese te pages se tyre bruto. Kompania nuk ka ndonje skeme tjeter pensioni dhe rrjedhimisht nuk ka ndonje detyrim tjeter ne lidhje me pensionet e punonjesve. Gjithashtu, kompania nuk eshte e detyruar te ofroje ndonje perfitim tjeter pas shkeputjes nga puna .

2.16 Provizionet

Provizionet njihen kur: kompania ka nje detyrim aktual ligjor ose konstruktiv si rezultat te ngjarjeve te shkuara ; eshte shume e mundshme perdorimi i burimeve per te mbuluar detyrimet e lindura , si dhe shuma e detyrimit eshte e matshme ne menyre te besueshme .

2.17 Llogari te Pagueshme

Llogarite e e pagueshme jane njohur fillimisht me vleren e drejte dhe me pas jane matur me koston e amortizuar.

2.18 Shpenzime te Tjera Operative

Shpenzimet e tjera operative jane njohur ne baze rrjedhese kur ato kane ndodhur .

2.19 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat perfshijne vleren e drejte te marre ose per t'u marre per aktivet e dhena me qera ne rrjedhen normale te biznesit. Te ardhurat jane pasqyruar neto nga Tatimi mbi Vleren e Shtuar.

Kompania njeh te ardhurat kur shuma e tyre mund te matet ne menyre te besueshme, eshte e mundur qe perfitime te ardhshme ekonomike do te hyjne ne kompani dhe jane respektuar kriteret e kompanise per secilin aktivitetet sic eshte pershkruar me poshte.

Te ardhurat nga qeraja financiare njihen ne baze te termave te qerases duke perdorur metoden e investimit neto, e cila reflekton nje norme konstante kthimi mbi investimin neto te qeradhenesit.

Te ardhurat nga qeraja fiananciare perfitohen ne avance ne baze mujore dhe pjesa mujore e ketyre ripagesave e cila lidhet me periudhen aktuale shtyhet.

Te ardhurat nga komisionet ju referohen tarifave te paguara kompanise nga kompanite e sigurimit per politikat e sigurimit te rena dakord me ta dhe njihen me baze rrjedhese.

Te ardhurat nga interesi njihen ne nje baze kohore duke perdorur metoden e interesit efektiv.
.

2.20 Krahasimi dhe riklasifikimet

Informacioni krahasues per vitin 2008 eshte paraqitur ne menyre konsistente duke aplikuar politikat kontabel te kompanise. Gjate vitit 2008, Kompania adoptoi per here te pare Standardet Nderkombetare te Kontabilitet dhe disa prej zerave te Bilancin jane riklasifikuar ne perputhje me keto standarde dhe konsistence ne paraqitje. Keto riklasifikime nuk kane ndryshuar rezultatin financiar te Kompanise te deklaruar me 2008

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

SHENIMI 3 – Te ardhurat nga interesi:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Qerate financiare	67,441,508	13,451,213
Te ardhura te tjera nga interesa	<u>3,423,218</u>	<u>2,115,041</u>
	<u>70,864,726</u>	<u>15,566,254</u>

Ne totalin e shitjeve per vitin 2009, interesi I faturuar dhe arketuar nga qerate financiare eshte pasqyruar si shitje te perjashtuara.

Nje permbledhje e qerave financiare te arketueshme jepet ne Shenimin 12

SHENIMI 4 – Shpenzimet per interesa:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne EUR)</i>	
Shpenzimet e interesit per huate e marra	<u>(28,745,908)</u>	<u>(6,933,680)</u>
	<u>(28,745,908)</u>	<u>(6,933,680)</u>

Shpenzimet e interesit te kompanise lidhen me huate e marra nga EELF,Dutsche Invesitons- und Entwicklungsgesellschaft mbH (DEG) dhe nga banka lokale dhe institucione financiare.

SHENIMI 5 – Te ardhurat nga komisionet:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Te ardhurat nga e komisionet e sigurimeve	<u>4,192,529</u>	<u>716,618</u>
	<u>4,192,529</u>	<u>716,628</u>

Te ardhurat nga komisionet e sigurimeve lidhen me pagesat e bera nga kompanite e sigurimit ndaj kompanise per policat e sigurimit te shitura mbi bazen e tarifave te kontraktuara me ta..

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

SHENIMI 6 – Shpenzimet administrative:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Sherbimet profesionale	4,773,470	18,600,290
Qera ambjenti dhe shpenzime te tjera te shfrytezimit	4,001,474	3,485,710
Te tjera	<u>7,510,572</u>	<u>3,490,787</u>
	<u>16,285,216</u>	<u>25,576,787</u>

SHENIMI 7 – Shpenzimet e personelit:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Pagat dhe shperblime	20,451,725	10,753,509
Kontributet per sigurime shoqerore	1,175,283	754,042
Kontributet shendetesore	163,172	104,632
Sherbimet e nenkontraktuara	230,950	285,685
Shpenzime te tjera te personelit	<u>541,350</u>	<u>172,200</u>
	<u>22,562,480</u>	<u>12,070,068</u>

SHENIMI 8 – Te ardhura te tjera:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne EUR)</i>	
Te ardhurat nga interesi nga depozitat me afat	1,421,787	828,608
Te ardhura te tjera	313,058	-
Te ardhuart nga interesi nga huatë e arketueshme	<u>48,323</u>	<u>-</u>
	<u>1,783,168</u>	<u>828,608</u>

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

SHENIMI 9 – Humbjet/Fitime neto nga kembimi:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Fitimet nga kembimi	69,4446,611	7,194,951
Humbjet nga kembimi	<u>(60,054,519)</u>	<u>(5,890,961)</u>
	<u>9,392,092</u>	<u>1,303,990</u>

Fitimet/ humbjet nga kembimi lidhen kryesisht rivleresimin e fundit te vitit qe ju behet llogarive te mbajtura ne valute te huaj. Ndikimi i kurseve te kembimit ne transaksionet e kompanise eshte i kufizuar meqe pagesat dhe arketimet behen kryesisht ne te njejten monedhe.

SHENIMI 10 – Tatimi mbi te ardhurat:

Ky tatim paguhet 10% (2008:10%) mbi fitimin operativ te rregulluar. Bashkerendimi ndermjet fitimit kontabel para taksave dhe shumes se tatimit mbi te ardhurat eshte sic vijon:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Fitimi kontabel para taksave	<u>18,195,090</u>	<u>(28,406,806)</u>
Perqindja lokale e tatimit mbi te ardhurat (10%)	1,819,509	(2,840,680)
Shpenzimet e pazbritshme (panjohura)	450,062	1,296,139
Humbjet e vitit aktual per te cilat nuk eshte njohur me pare ndonje e drejte tatimore e shtyre	-	1,719,376
Perdorimi i humbjeve tatimore te mbartura	<u>(1,556,632)</u>	<u>-</u>
Tatimi Aktual mbi te Ardhurat	<u>712,939</u>	<u>(174,835)</u>
Tatimi aktual mbi te ardhurat	(712,393)	-
Kreditimi i te ardhurave/ shpenzimeve tatimore te shtyra (shenimi 16)	<u>1,197,637</u>	<u>(174,835)</u>
Kreditimi i te ardhurave/ shpenzimeve tatimore	<u>485,244</u>	<u>(174,835)</u>

Ne 2008, kompania realizoi nje humbje tatimore ne shumen totale prej 15,566 mije LEK. Humbjet tatimore mund te mbarten per nje periudhe 3 vjetcare prej vitit kur humbja eshte njohur. Humbja tatimore e njohur ne vitin 2008 iu zbrit fitimit tatimor te realizuar nga kompania ne 2009.

Ne baze te legjislacionit lokal, Autoriteti Tatimor mund te inspektojte ne cdo kohe librat dhe regjistrimet e mbajtura nga kompania brenda nje periudhe 5 vjecare nga peiudha kur eshte deklaruar detyrimi tatimor dhe mund te jape vleresime shitese te tatimeve te llogaritura dhe

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

deklaruara si dhe penalitete. Manaxhimi I kompanise nuk eshte ne dijeni te ndonje rrethane e cila mund te ndikojte ne lindjen e nje detyrimi te mundshem material ne kete drejtim.

SHENIMI 11 – Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Paraja ne Banke	7,755,984	28,888,082
Depozitat afat- shkurtra	41,388,000	-
Interesi I llogaritur per depozitat afat- shkurtra	22,901	-
	<u>49,166,885</u>	<u>28,888,082</u>

Norma e interesit e depozitave me afat nje- javor ne Euro me Raiffeisen Bank Albania ne 31 Dhjetor 2009 ishte 2.8%.

SHENIMI 12 – Llogari Te arketueshmet nga qerate financiare:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Qera Financiare te arketueshme nga persona juridike	680,538,619	199,596,792
Qera Financiare te arketueshmet individet	136,777,871	71,345,126
	<u>817,316,489</u>	<u>270,851,981</u>
Parapagesat e marra ne avance per qerate financiare	-	(2,345,143)
	<u>817,316,489</u>	<u>2,161,210</u>
Zhvleresimi	(1,318,398)	(1,815,081)
Te ardhura te shtyra	(1,886,127)	(982,340)
Interesa te Maturuara		33,312
	<u>814,111,465</u>	<u>265,742,666</u>

SHENIMI 12 – Qera Financiare te arketueshme (Vazhdim)

Kompania ofron qera financiare per , automjete dhe paisje, makineri.

Qerate Financiare te arketueshme mbahen teresisht ne EUR.

Normat efektive te interest variojne nga 7.8% ne 14.7% per qerate fianciare te arketueshme ne EUR.

Vlera e mbartur e nga qerate financiare te arketueshme eshte e perafert me vleren e tyre te drejte, meqe normat e interest lidhen drejperdrejt me normat e indekseve te tregut (per shembull: Euribor 3 deri 12 mujor) dhe ndryshon sipas nje baze kohore.

SHENIMI 13 – Huate dhe Llogarite e arketueshmet e tjera:

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Huate e arketueshme	3,449,000	-
Interesi rrjedhes I llogaritur mbi huate e arketueshme	4,415	-
Llogarite e arketueshme(Klientet)	3,142,602	4,311,886
Te arketueshmet nga furnitoret	-	973,526
	<u>6,596,017</u>	<u>5,285,412</u>

Drejtorit Ekzekutiv te kompanise iu akordua nje hua me afat maturimi 2 vjet dhe me norme efektive interesi 5.22%.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

SHENIMI 14

AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JO MATERIALE, Neto

	Pajisje motorike	Pajisje zyre	Mobilje	Kompjuterat	Programe kompjuterike	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2008	1,260,720	282,929	403,236	140,625	16,000	2,103,510
Shtesat gjatë vitit		193,510	93,000	527,008		813,518
Më 31 dhjetor 2008	1,260,720	476,439	496,236	667,633	16,000	2,917,028
Shtesat gjatë vitit	1,904,310	1,958,408	35,000		7,923,392	6,625
Shitje gjate vitit	(1,260,720)					
Më 31 dhjetor 2009	3,165,030	2,434,847	531,236	667,633	7,939,392	14,738,138
Zhvlerësimi						
Më 1 janar 2008	(63,036)	(123,483)	(156,122)	(71,412)	(1,867)	(415,920)
Shpenzimi për vitin	(239,537)	(57,690)	(51,907)	(74,699)	(2,827)	(426,660)
Më 31 dhjetor 2008	(302,573)	(181,173)	(208,029)	(146,111)	(4,694)	(842,580)
Shpenzimi për vitin	(143,722)	(407,100)	(57,991)	(204,196)	(2,261)	(3,475)
Shitje gjate vitit	446,295					
Më 31 dhjetor 2009	0	(588,273)	(266,020)	(350,307)	(6,955)	(1,211,555)
Vlera kontabël, neto						
Më 31 dhjetor 2008	958,147	295,266	288,207	521,522	11,306	2,074,448
Më 31 dhjetor 2009	3,165,030	1,846,574	265,216	317,326	7,932,437	13,526,583

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

SHENIMI 15 – Tatimet e Shtyra

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	(ne LEK)	
Aktivet tatimore te shtyra		
Teprica e llogarise ne 1 Janar	-	-
teprica kreditore e pasqyres se te ardhurave	1,222,424	-
Teprica ne fund te vitit	<u>1,222,424</u>	<u>-</u>
Detyrimet tatimore te shtyra		
Teprica e llogarise ne 1 Janar	547,078	372,243
Shpenzimet nga pasqyra e te ardhurave	24,211	174,835
Teprica e llogarise ne fund te vitit	<u>571,289</u>	<u>(547,078)</u>
	<u>651,135</u>	<u>(547,078)</u>

SHENIMI 16 – Aktivet e tjera

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	(ne LEK)	
<i>Jo financiare</i>		
TVSH e arketueshme	143,962,204	47,001,655
Shpenzimet e parapaguara	<u>23,413,365</u>	<u>1,752,638</u>
	167,375,569	48,754,293
<i>Financiare</i>		
Komisionet rrjedhese te llogaritura	<u>663,245</u>	<u>70,782</u>
	<u>168,038,814</u>	<u>48,825,075</u>

Parapagimet lidhen me pagesat e bera ne avance per aktivet te cilat ne momentin qe do te levrohen do te perdoren per t'u dhene me qera financiare sipas kontratave te nenshkruara.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

SHENIMI 17 – KREDITE DHE HUATE E MARRA

	2009	2008
	(ne LEK)	
Afat-shkurtra (Korente)		
Huate bankare	44,265,294	35,066,226
Hua te tjera	233,053,785	30,047,251
Afat-gjata		
Huate bankare	57,643,413	49,622,630
Hua te tjera	417,212,286	91,886,217
Totali i huave	752,174,773	206,622,324

Kompania ka marre hua nga institucionet dhe bankat e meposhtme. Shumat jane shprehur ne monedhen ne te cilen eshte marre kredia:

Lender	Monedha	Data e fillimit	Data e maturimit	Shuma totale e huase	Pjesa e papaguar 31.12.2009
EELF (1)	EUR	30.9.2008	31.1.2013	2,000,000	1,617,750
EELF (2)	EUR	14.10.2009	14.3.2010	400,000	402,518
DEG	EUR	16.2.2009	16.10.2013	3,000,000	2,676,110
Banka Popullore – Societe Generale (1)	EUR	24.11.2008	14.11.2011	211,385	137,334
Banka Popullore - Societe Generale (2)	EUR	14.11.2008	14.11.2012	153,600	113,516
Banka Popullore - Societe Generale (3)	EUR	14.11.2008	14.11.2013	128,963	102,087
Banka Popullore - Societe Generale (4)	EUR	30.12.2008	30.12.2013	64,012	52,410
Banka Popullore - Societe Generale (5)	EUR	19.1.2009	19.1.2013	228,986	180,218
Banka Popullore - Societe Generale (6)	EUR	15.1.2009	15.1.2011	76,000	42,175
Banka Popullore - Societe Generale (7)	EUR	08.1.2009	08.1.2012	133,075	94,760
First Investment Bank	EUR	02.10.2006	02.10.2010	50,000	11,938
Emporiki Bank	EUR	11.4.2007	12.4.2010	38,000	4,245
Credins Leasing	EUR	21.12.2009	21.12.2013	17,250	17,060
				6,501,271	5,452,122

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

Per huate e siguruara nga kompania paguhet interes I cili varion nga EURIBOR 3 mujor + 2.5% ne 12M EURIBOR + 6%. Te gjitha huate mbahen ne EUR. EELF, Emerging Europe Finance and Leasing eshte kompania meme. DEG (Deutsche Investitions- und Entwicklungsgesellschaft) eshte nje anetar I KfW Bankengruppe dhe nje nga aksioneret e Balkan Accession Fund, si dhe aksioneri kryesor i EELF. Huadhenesit e tjere jane banka lokale dhe institucione financiare.

Huate e pasiguruara jane huate e marra nga EELF, Emerging Europe Finance and Leasing e cila eshte dhe kompania meme.

Nuk asnje shume te paperdorur ngakredite e aprovuara deri ne 31 Dhjetor 2009.

SHENIMI 18 – DETYRIME NDAJ FURNITOREVE DHE KLIENTEVE

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	(ne LEK)	
Pagesa te bera ne avance nga klientet	8,427,853	4,225,689
Llogari te pagueshme (Furnitore)	<u>18,183,547</u>	<u>16,029,371</u>
Totali te pagueshmeve	<u>26,611,399</u>	<u>20,255,060</u>

SHENIMI 19 – DETYRIMET E TJERA

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	(ne LEK)	
Taksa te tjera te pagueshme	698,637	1,232,075
Te pagueshmet ndaj furnitoreve	<u>-</u>	<u>15,000</u>
Totali I detyrimeve te tjera	<u>698,637</u>	<u>1,247,075</u>

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

SHENIMI 20 – Kapitali I regjistruar

	<u>2009</u>	<u>2008</u>
	<i>(ne LEK)</i>	
Kapitali I regjistruar dhe I paguar	<u>239,838,000</u>	<u>108,788,000</u>

Pronaret e kompanise ne vitin 2009 dhe 2008 paraqiten me poshte:

	<u>2009</u>		<u>2008</u>	
	Numri I aksioneve	%	Numri I aksioneve	%
Emerging Europe Leasing and Finance (EELF) B.V	172,243	71.82%	72,909	67.02%
Hysen Ruka	56,293	23.47%	18,836	17.31%
Basri Ruka	-	-	8,910	8.19%
Ibrahim Kruja	-	-	3,349	3.08%
Altin Saliasi	7,911	3.30%	3,349	3.08%
Stephen Strauss	3,391	1.41%	1,435	1.32%
	<u>239,838</u>	<u>100.00%</u>	<u>108,788</u>	<u>100.00%</u>

Kompania ka emetuar aksione te zakonshme me vlere nominale 1000 LEK per aksion, te paguara plotesisht. Rezervat ligjore nuk jane krijuar meqe ne vitin 2008 rezultati I kompanise ishte negativ.

SHENIMI 21 – Kontigjencat dhe angazhimet

Angazhimet e qerave operative

Kompania jep me qera ambjente biznesi ne kushtet e nje kontrate te nje qeraje operative. Ne lidhje me qerane e mjediseve te biznesit nuk ka shpenzime shtese ne rast te perfundimit te mareveshjes dhe cdo mareveshje mund te perfundoje me nje lajmerim paraprak perfundimi te pakten 60 dite perpara.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009

SHENIMI 22 – VEPRIME ME PALE TE LIDHURA

Balancat e arketueshme dhe te pagueshme nga veprimet me palet e lidhura per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009 dhe 2008 jane si me poshte :

<i>(te gjitha shumat jane shprehur ne LEK)</i>	Marredhenia me Kompanine	Shenimi	2009	2008
Hua	Drejtori Ekzekutiv	15	3,453,415	-
Qera Financiare te Arketueshme				
BIS Sh.p.k	Pale e lidhur me Aksioner		-	9,088,281
BINDI Sh.p.k	Pale e lidhur me Aksioner		360,352	897,550
Avidje Ruka	Pale e lidhur me Aksioner		1,948,823	-
Hysen Ruka	Aksioner		4,393,060	-
			6,702,235	9,985,731
Borrowings		20		
EELF	Aksioner		278,716,311	120,699,058
DEG	Aksioner ne EELF		369,196,136	-
			647,912,447	120,699,058

SHENIMI 23 – NGJARJET PAS BILANCIT

-Kompania ka te aprovuar ne Shkurt 2010 nje kredi afatgjate prej 4 milion Euro nga nje institucionin financiar hollandez FMO. Kredia eshte aprovuar me nje afat prej 5 vjetesh , interes variable Euribor 6 mujor +4.675, me afat 5 vjet.

- Kompania ka te aprovuar gjithashtu ne Shkurt 2010 nje kredi prej 1 milion Euro nga Banka Europiane per Zhvillim dhe Rindertim , me interes Euribor 6 mujor+4.675%, me afat 5 vjet. Nuk ka ngjarje te tjera te rendesishme te evidentuara pas dates se Bilancit.

Altin Saliasi

Drejtor Ekzekutiv

Valbona Gaxha

Menaxhere Finances e Kontabilitetit

